

Schulpsychologischer Dienst
Schützenstrasse 3
8403 Winterthur
Telefon 052 267 55 37



Shërbimi psikologjik shkollor

Shërbimi psikologjik shkollor (Schulpsychologischer Dienst (SPD)) i qytetit të Winterthur-it është një qendër këshillimi publike që synon të shoqërojë prindërit, fëmijët/të rinjtë dhe personat e specializuar të shkollës. Ne mbështesim proceset e zgjidhjes në fushën e shkollës dhe familjes në mënyrë ndërdisiplinore dhe të orientuar sipas burimeve. Oferta jonë drejtohet ndaj fëmijëve dhe të rinjve në kohën e shkollës së detyruar. Shërbimet tona janë pa pagesë për klientët tanë dhe ne i nënshtrohemi detyrimit për ruajtjen e fshehtësisë.

Si psikologe dhe psikologë, ne e shohim punën tonë si parandaluese, këshilluese dhe shoqëruese. Ne orientohemi në pika të forta ekzistuese dhe përpiqemi për zgjidhje efektive të afta për konsensus si dhe integruese të cilat kanë në fokus zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve dhe të rinjve.

Ju na kontaktoni nëpërmjet [formularëve tanë të regjistrimit](#). Ju mund të na kontaktoni me kënaqësi edhe me telefon.